



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTRRI

Numri i lëndës: 2019:228935

Datë: 21.03.2024

Numri i dokumentit: 05482195

C.nr.176/17

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË–DEGA NË VUSHTRRI, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtarin Jeton Zymeri, në çështjen juridike kontestimore të paditëses B.. me seli në Prishtinë, rruga... të cilën e përfaqëson Kompania V.. SH.P.K me seli në Fushë Kosovë, rr... me autorizim F.L, kundër të paditurit E.K nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, me objekt kontesti Rimbursim dëmi, në pajtim me nenin 399 të LPK –së, jashtë seance më datë 21.03.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pa bazuar kërkesëpadia për Rimbursim të dëmit në shumën prej 690.00 euro, e datës 18.04.2017, e paditëses B.. nga Prishtina, rruga .. kundër të paditurit E.K nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, për shkak të parashkrimit.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësja B.. nga Prishtina, rruga .. përmes të autorizuarit të saj, me datë 18.04.2017, ka paraqitur padi kundër të paditurit E.K nga fshati ..., Komuna e Vushtrrisë, për rimbursim të dëmit në shumën prej 690.00 euro, të shkaktuar në aksidentin e komunikacionit të datës 30.03.2013, në fshatin .. Komuna e Obiliqit, me ç ’rast i shkaktohet dëm material personit E.M. Ka shtuar se në procedurë jashtëgjyqësore të dëmtuarit E.M, i është kompensuar dëmi material dhe jo material i pësuar si rezultat i aksidentit. Andaj bazuar në këto arsye ka kërkuar që gjykata ta detyroj të paditurin E.K, t’ia rimburoj dëmit të shkaktuar në shumën prej 690.00 euro.

Gjykata me datë 20.03.2024, ka mbajtur seancën përgatitore në të cilën i autorizuari i paditëses ka mbetur pranë padisë dhe kërkesëpadisë dhe ka theksuar se sipas raportit policor me nr.13-DR-0869 të datës 30.03.2013, i paituri E.K, me automjetin e markës Daimler Benz- kamion transporti, pa targa të regjistrimit, ka shkaktuar aksident trafiku, me ç ’rast i ka shkaktuar dëme materiale të dëmtuarit E.M, i padituri në momentin e shkaktimit të aksidentit nuk ka poseduar polisë valide të sigurimit, me ç ’rast sipas LSDA-së, neni 18, përgjegjës për kompensimin e dëmeve të shkaktuara nga automjetet pa sigurim është BKS, e cila pas procedurës së kompensimit ka të drejtë në rimbursim. Andaj, ka kërkuar nga gjykata që padinë ta aprovojë si të bazuar dhe të obligohet i padituri që në emër të rimbursimit të dëmit material të paguajë shumën si në padi. Njëkohësisht palës së paditur i ka ofruar mundësinë që të arrijnë marrëveshje gjyqësore, i cili do të ketë mundësi që ta paguajë këtë shumë prej 690.00 në 12 këste ku shumata e këstit do të jetë 59 euro.

I padituri E.K ka deklaruar se aksidenti ka ndodhur me datë 30.03.2013, paditësja B., kompensimin e dëmit të dëmtuarit E.M ia ka bërë me datë 16.05.2013, ndërsa padinë e ka parashtruar në gjykatë me datë 18.04.2017, ndërsa afati për paraqitjen e padisë ka qenë tri vite, përkatësisht se padia është paraqitur pas afatit dhe i ka propozuar gjykatës që të shikojë afatet kohore dhe të konstatojë nëse padia është paraqitur pas afatit.

Përfaqësuesi i paditësit e ka kundërshtuar deklarinimin e të paditurit për parshkrim, duke ia lënë në diskrecion gjykatës që të vendosë nëse kërkesëpadia është e parashkruar.

Pasi që nuk kishte propozime për prova të reja, gjykata bëri leximin dhe administrimin e provave si: dosja e dëmit nr.676/13, Urdhërtransferi i datës 16.05.2013, Ujdia jashtëgjyqësore e datës 29.04.2013, Vendimi i datës 15.04.2013 dhe Raporti i aksidentit i datës 30.03.2013.

Fillimisht gjykata e mori parasysh parashkrimin e parashtruar nga i padituri, bazuar në nenin 341 par.3 të Ligjit Nr. 04/L-077 për Marrëdhëniet e Detyrimeve.

Gjykata, pas shqyrtimit të padisë, shkresave të lëndës dhe deklarinimin e të paditurit, në kuptim të nenit 8 të Ligjit të Procedures Kontestimore (LPK), gjeti se kërkesëpadia e paditëses ndaj të paditurit, është e pa bazuar sepse e drejta e paditëses për të kërkuar Rimbursimin e dëmit, është parashkruar.

Me nenin 342 par.1 të Ligjit të lartcekur përcaktohet se *Parashkrimi fillon të rrjedhë ditën e parë pas ditës kur kreditori të ketë pasur të drejtë të kërkojë përmbushjen e detyrimit, në qoftë se me ligj për raste të veçanta nuk është parashikuar diçka tjetër*”.

Me nenin 357 par.1 të Ligjit të lartcekur përcaktohet se *Kërkesa për shpërblimin e dëmit të shkaktuar parashkruhet për tri (3) vite nga data kur i dëmtuari ka marrë dijeni për dëmin dhe për personin, i cili e ka shkaktuar dëmin*. Ndërsa në nenin 362 par.1 të të njëjtit ligj përcaktohet se *Kërkesat e kontraktuesve të sigurimit, respektivisht të personit të tretë nga kontrata e sigurimit të jetës, parashkruhen për pesë (5) vjet, kurse nga kontratat e tjera për sigurimin për tre (3) vjet, duke llogaritur që nga dita e parë pas kalimit të vitit kalendarik në të cilin është krijuar kërkesa*.

Në nenin 369 të LMD –së, është përcaktuar se *“Parashkrimi ndërprehet me paraqitjen e padisë dhe me çdo veprim tjetër të kreditorit të ndërmarrë kundër debitorit para gjykatës ose autoritetit tjetër kompetent me qëllim vërtetimi, sigurimi ose realizimi të kërkesës”,* ashtu që gjykata në shkresat e lëndës nuk ka arritur që të vërtetojë ekzistimin e ndonjë prove relevante e cila do ta kishte ndërprerë parashkrimin e kërkesës së paditëses.

Nga interpretimi i këtyre dispozitave ligjore, gjykata konstatoi se padia e paditëses B.. për rimbursimin e dëmit është paraqitur pas afatit. Rrjedhimisht nga shkresat e lëndës gjykata konstatoi se ujdia gjyqësore për kompensimin e dëmit në mes të paditëses dhe të dëmtuarit është arritur më datë 29.04.2013, ndërsa pagesën e dëmit këtu paditësja të dëmtuarit ia ka bërë sipas urdhërtransferit bankar me datë 16.05.2013 dhe nga kjo datë është krijuar e drejta e saj që të kërkojë rimbursimin e dëmit nga i padituri E.K, ndërsa padinë për rimbursim e ka paraqitur me datë 13.04.2017, e cila është pranuar në gjykatë me datë 18.04.2017, pra pas 3 viteve e 11 muajve.

Gjykata në rastin konkret vlerëson se kërkesa e palës paditëse është përfshirë në parashkrimin shues (humbës), kjo referuar pretendimeve të lartcekurave të palës paditëse dhe kohës së dorëzimit të padisë në gjykatë, nga ku vërtetohet fakti se padia është parashtruar pas kalimit të afatit prej më shumë se 3 viteve, nga dita kur paditësja ka marr dijeni për dëmin dhe për personin që ka shkaktuar dëmin.

Meqenëse në rastin konkret kërkesëpadia e paditëses refuzohet si e pabazuar, kjo për shkak të ekzistimit të parashkrimit të së drejtës së paditëses, gjykata nuk ka dhënë vlerësimin e saj për pretendimet e tjera faktike, dhe për provat me të cilat do të vërtetoheshin pretendimet faktike,

përveç atyre që i referohen rrethanave lidhur me (mos) ekzistimin e pretendimeve të palëve, për parashkrimin e kërkesës së paditëses.

Andaj gjykata ka gjetur si të bazuar pretendimin e të paditurit se në këtë rast kemi të bëjmë me afat 3 vjeçar të parashkrimit, ngase është ditur qartësisht se kur është kompensuar i dëmtuari, kush është shkaktar i aksidentit dhe se afati 3 vjeçar i parashkrimit nga dita e arritjes së ujdisë gjyqësore respektivisht urdhërtransferi bankar i bërë nga ana e paditëses i datës 16.05.2013.

Përkitazi lidhur me vlerësimin e këtyre rrethanave, gjykata ka vlerësuar se paditësi ka humbur mundësinë për realizimin e kërkesës që rimbursimin e dëmit ta realizojë në rrugë gjyqësore.

Për këtë çështje, gjykata, vendosi në mënyrë meritore, pa mbajtur shqyrtimin kryesor, konform nenit 399 të LPK –së, në të cilin është përcaktuar se “Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia. Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura.

Gjykata vendosi ta refuzoj kërkesëpadinë e paditëses në kuptim të dispozitave të cituara, sipas të gjeturave faktike të përshkruara më lartë.

Vendimin lidhur me shpenzimet e procedurës si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi, gjykata e mbështeti në nenin 450 të LPK-së, marr parasysh se paditësja e ka humbur kontestin, ndërsa i padituri nuk i ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

Nga sa u tha më lartë, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi e duke u bazuar në nenin 143.1 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË-DEGA NË VUSHTRRI

Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil

C.nr.176/17, me datë 21.03.2024

Gj y q t a r i

Numri i lëndës: 2019:228935
Datë: 21.03.2024
Numri i dokumentit: 05482195

Jeton Zymeri

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, pas pranimit të tij me shkrim, gjykatës së Apelit në Prishtinë përmes kësaj gjykate.